



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.902/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkalles së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Arda Rei Group shpk, me nr. Biznesi 71203840, me seli ne Bulevardin “Bill Clinton” pn, Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatura “Ramaj&Palushi”L.L.C, me seli ne Prishtinë, kundër debitorit “Suma Enginiering Platform” D.o.o-Dega ne Kosovë, me nr. Biznesi 71326675, me seli ne lagjen Kalabria Blloku C1, Obj.2 nr.23 Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson “Deloitte Kosova” shpk, me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë. KPPP.nr.324/22 datës 28.04.2023, me datën 05.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Arda Rei Group shpk, me nr. Biznesi 71203840, me seli ne Bulevardi “Bill Clinton” pn, Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.324/22 i datës 28.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.324/22 dt.28.04.2023, ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Suma Enginiering Platform D.o.o-Dega ne Kosovë, me nr. Biznesi 71326675, me seli ne lagjen Kalabria Blloku C1, Obj.2 nr.23 Prishtinë, të ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.045/18 dt.25.01.2018, të Përmbarueses Private Rrezarta Metaj në Prishtinë, ka anuluar Urdhrin përmbarimor P.nr.045/18 dt.25.01.2018, ndërsa ka Hedhur kërkesën për kthim ne gjendje te mëparshme e paraqitur nga debitori Suma Enginiering Platform D.o.o - Dega ne Kosovë dt.15.03.2015, si të palejuar.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, për shkak te vërtetimit të gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Dhomat e shkallës së dytë, këtë ankesë ta aprovoj si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta ndryshoj ndërsa Urdhrin përmbarimor P.nr.045/18 dt.25.01.2018 ta vërtetoj.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Arda Rei Group me datën 08.02.2018, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Suma Engineering Platform, D.o.o-Dega ne Kosovë, me nr. Biznesi 71326675, me seli ne lagjen Kalabria Blloku C1, Obj.2 nr.23 Prishtinë, në bazë të dokumenti të besueshëm - Faturës nr.17-SHV04-001-275 dt.29.11.2017.

Përmbartuesja Private Rrezarta Metaj nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka nxjerrë urdhrin përmbartimor P.nr.045/18 dt.25.01.2018, me të cilin e ka lejuar përmbartimin, duke e detyruar debitorin që në emër te detyrimit nga fatura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 11,446.00€ me kamatë ligjore prej 8% vjetore si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 15.03.2018, me arsyetimin se nuk kanë pasur marrëveshje me kreditorin dhe nuk ka pranuar asnjë lloj shërbimi nga ana e tij. Fatura nuk ka tipare te përmbartueshmërisë siç pretendohet andaj nuk qëndron as pretendimi i kreditorit që kinse debitori ka injoruar kërkesat e dërguara nga kreditori për pagesën e borxhit. Kreditori nuk mund ta argumentoj asnjërin nga pretendimet e tij ne propozim për përmbartim sepse nuk ka pasur marrëveshje me të, andaj propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta vërtetoj ndërsa kreditorin ta detyroj ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 21.03.2018, me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori ne prapësimin e tij sepse prapësimi nuk është i mbështetur ne prova dhe ne ligj, debitori nuk e konteston faturën e kreditorit e cila i është dërguar përmes emailit dhe e njëjta është pranuar nga debitori ashtu qe përben dokument te besueshëm mbi bazën e te cilit kreditori ka ushtruar propozim për përmbartim. Fatura është e rregullt dhe përmban te gjitha te dhënat për debitorin dhe kreditorin , nënshkrimi dhe vula e kreditorit dhe se është dërguar me e-mail, e njëjta debitorit i është dërguar edhe me datën 29.11.2017, ne vend punishten e tij ne Kaçanik. Shton se me debitorin kanë pasur marrëveshje për shfrytëzim të gjeneratorit për periudhën kohore 01.05.2017 deri me 07.09.2017, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta vërtetoj.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.324/22 dt.28.04.2023, me të cilin e ka Pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, ka Anuluar Urdhrin përmbartimor, ndërsa Kërkesën për kthim ne gjendje te mëparshme te paraqitur nga debitori e hedh si te palejuar. Në arsyetim të

aktvendimit, gjykata konstaton se në ri procedurë dhe pas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit në aktvendimin A.nr.2759/19 dt.20.11.2020, ka gjetur se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar procedura përbarimore nuk është i përshtatshëm për përbarim në mungesë të dëshmive për pranimin e faturës nga ana e debitorit. Gjykata arsyeton se në bazë të vërejtjeve nga Gjykata e Apelit vendos edhe për kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, gjykata ka trajtuar prapësimin dhe ka gjetur se duke vepruar sipas propozimit për përbarim Përbaruesi Privat komunikimin me debitorin e ka vazhduar përmes publikimit të urdhrin përbarimor në tabelën e shpalljeve pasi nuk ka mundur të dorëzojë urdhrin përbarimor debitorit në adresën e tij dhe atë me dy tentime për dorëzim përmes postes dhe atë me datën 09.02.2018 dhe 20.02.2018 nga ku ka rezultuar se pala është e panjohur, ashtu që në tabelën e shpalljeve përbaruesi e ka publikuar me datën 27.02.2018 i cili komunikim është konsideruar i rregullt me datën 09.03.2018, ndërsa prapësimin debitori e ka paraqitur me datën 15.03.2018. Gjykata në lidhje me këtë i referohet nenit 18 të LPP dhe nenit 114 të LPK. Urdhri përbarimor është konsideruar i rregullt me skadimin e afatit prej 7 ditësh nga dita e afishimit për të ushtruar mjetin juridik të prapësimin pra deri me datën 16.03.2018 dhe kjo në kuptim të nenit 70 të LPP. Gjykata pas analizimit të prapësimin vlerësoi se pretendimet në prapësim të debitorit marrë për bazë edhe vërejtjet e Gjykatës së Apelit janë të bazuara, fatura nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sepse në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori pasi e njëjta nuk është e nënshkruar dhe në lëndë nuk ka prova se fatura është dorëzuar në mënyrë të rregullt, debitori nuk ka konfirmuar pranimin e e-mailit se bashku me faturën në mënyrë që gjykata ta konsideroj si të rregullt pranimin e faturës së bashku me detyrimin që rrjedh nga ajo. Gjykata i referohet edhe nenit 129 të LPK ashtu që kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e ushtruar nga debitori është e palejuar sepse debitori nuk e ka lëshuar afatin për kryerjen e veprimit procedural atë të parashtrimit të prapësimin ndaj urdhrin përbarimor. Gjykata i referohet edhe nenit 2 par.4 të LPK dhe nenit 71 par.1.1 dhe 73 të LPP dhe nenit 12 par.2 të këtij ligji, andaj bazuar në këto arsye edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përbarimor dhe ka hedh si të palejuar kërkesën e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë. Mbi bazën e këtyre rrethanave si edhe provave në lëndë edhe kjo gjykatë vlerëson se organi përbarues ka tentuar dy herë që përmes postës debitorit ti dorëzojë urdhrin përbarimor dhe atë me datën 09.02.2018 dhe 20.02.2018 por i ka rezultuar se pala është e panjohur. Pas këtyre veprimeve Organi Përbarues urdhrin përbarimor e ka publikuar në tabelën e shpalljeve me datën 27.02.2018, në pajtim me nenin 114 të LPK-së. Më tutje bazuar në shkresat e lëndës

përkatësisht fletë dërgesën për dorëzim personal, del se debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datën 14.03.2018, nga rezulton se debitori nuk e ka lëshuar afatin për kryerjen e veprimit procedural, në mënyrë që të kërkoj kthim në gjendje të mëparshme ashtu siç ka vepruar, sepse debitori prapësimin ndaj urdhrin përmbarimor e ka ushtruar me datën 15.03.2023 brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 70 të LPP-së, për kryerjen e veprimeve të tij procedurale.

Sa i përket faktit se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi, edhe kjo gjykatë vlerëson se kjo faturë nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, sepse në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori pasi e njëjta nuk është e nënshkruar dhe në lende nuk ka prova se fatura është dorëzuar në mënyrë të rregullt tek debitori. Kjo gjykatë vlerëson se fatura me nr.17-SHV04-001-275 dt.29.11.2017, e cila i është bashkangjitur propozimit për përmbarim dhe në bazë të cilës kërkohet përmbushja e detyrimit nga debitori, nuk i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 29 par.3 i cili thotë se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*. Fatura në fjalë nuk është nënshkruar nga debitori si dhe as vulosur nga ana e tij dhe se konsiderohet se është lëshuar njëanshëm nga kreditori, prandaj si e tillë nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm dhe as nuk mund të ekzekutohet sipas dispozitave të LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë, i analizoi pretendimet e kreditorit se dhoma e shkallës së parë ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe ka zbatuar gabimisht edhe të drejtën materiale, por vlerëson se këto pretendime janë të paqëndrueshme dhe të paargumentuara sepse i njëjti nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të tyre, dhe si të tilla nuk janë relevante për një vendosje ndryshe nga ajo çka ka vendosur dhoma e shkallës së parë. Nuk janë të vlefshme dhe të bazuara në ligj, pretendimet në ankesë se komunikimi përmes postës elektronike konfirmon pranimin e faturës nga debitori.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.902/23 me datë 05.02.2024

Gjyqtar
Krenar Berisha